

Procedurat e Sigurimit të Cilësisë - (Normat e kalueshmerise se Programit)

Rezultati i procedurës së vlerësimit të cilësisë diskutohet me anëtarët e stafit. I gjithë personeli duhet të hartojë plane individuale të zhvillimit profesional që përvijojnë metodat e mësimdhënies dhe të mësimnxënies, aftësitë kërkimore dhe teknike.

Procedura e mëposhtme kryhet nga Nënkomiteti i Sigurimit të Cilësisë:

- ***Procedurat për monitorimin e vazhdueshëm të programeve*** – Qëllimi i këtyre procedurave është të siguroj që proceset sistematike ekzistojnë dhe menaxhohen në mënyrë që të mbliidhen dhe analizohen informacionet që mbështesin përmirësimin e vazhdueshëm të programeve, të monitorojnë arritjet e studentëve në lidhje me rezultatet e deklaruara të të nxënit të programeve dhe të vlerësojnë efektivitetin e mekanizmave të vlerësimit të programit. Të krijojë një kulturë cilësore brenda Kolegjit si në nivel personeli ashtu edhe student, në mënyrë që palët e interesuara të jenë të vetëdijshme për rolet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me cilësinë e programit, duke mbështetur rishikimet e përgjithshme periodike të institucionit dhe fakulteteve. Metrikë shtesë për monitorim, të tilla si nivelet e angazhimit të studentëve dhe nivelet e suksesit pasuniversitar monitorohen për të vlerësuar më tej efektivitetin e programit.
- ***Procedurat kryesore që duhen ndjekur në këtë fushë janë si më poshtë:*** Këshillat e Fakultetit krijohen për secilin nga programet e Kolegjit – fokusi kryesor i Këshillit është të monitoroj dhe përmirësoj ofrimin e vazhdueshëm të programeve për të cilat ata janë përgjegjës. Këshilli gjithashtu do të kërkoj dhe integroj në mënyrë aktive reagime nga tendencat e industrisë dhe kërkesat e tregut të punës për ta mbajtur kurrikulën relevante dhe largpamëse. Këshilli përbëhet nga Dekani, i gjithë stafi akademik që ligjëron programin, përfaqësues të stafit mbështetës, përfaqësues të studentëve dhe përfaqësues të industrisë. **Një seminar vjetor i Fakultetit zhvillohet për të lehtësuar ndarjen e praktikave më të mira në mësimdhënie në të gjithë Fakultetin.** Këshilli do të plotësojë dhe do t'i paraqesë Këshillit Akademik një Raport Vjetor të Programit për secilin program sipas Procedurave Standarde të Operacionit dhe Treguesve Kryesor të Performancës. Menaxhmenti i Fakultetit do të marrë parasysh raportet, çështjet kritike të performancës dhe rekomandimet. Vlerësimi i programit nga studentët zbatohet nga Komisioni i Sigurimit të Cilësisë së Fakultetit. Vlerësimi merret nga Pyetëtori i Studentëve të cilët janë dakorduar në nivel institucional. Çdo student kryen një anketë formale duke përdorur PyetëSORIN Standard të paktën një herë në vit akademik. Për çdo lëndë dhe pedagog përgatitet një përmbledhje e shkurtër. Informacionet sensitive i raportohen vetëm Dekanit.
- ***Procedurat për vlerësimin e programit*** - Institucioni ndërmerr një vlerësim të rregullt periodik të programeve një herë në tre vjet. Kjo procedurë zbatohet si pjesë e procesit të akreditimit dhe është thelbësore për të siguruar që oferta t'i përgjigjet nevojave të

studentëve dhe tregut të punës. Procesi i vlerësimit shërben për të rishikuar rezultatet e të nxënës të programit, metodologjinë e mësimdhënies dhe të nxënës të programit, vlerësimin dhe kurset e tij. Procesi i vlerësimit shqyrton gjithashtu rezultatet e programit, të diplomuarit dhe ndikimin në industri dhe komunitet. Procesi përbëhet nga: vetëvlerësimi i programit, strategjia e programit dhe dokumenti i rishikimeve të propozuara. Përbërja e vetëvlerësimit të programit rregullohet nga Procedurat Standarde të Operacionit dhe përfshin: Dekanin, Kryetarët e Departamenteve, dy anëtarë të stafit akademik, përfaqësuesin e studentëve, përfaqësuesin e të diplomuarve, administratorin e programit, zyrtarin e shërbimeve studentore dhe përfaqësuesit e industrisë. Procesi i vetëvlerësimit mund të përfshijë edhe ekspertë të jashtëm.

- ***Procedurat për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin dhe zhvillimin e stafit*** - Procedurat e sigurimit të cilësisë në procesin e përzgjedhjes, vlerësimit dhe zhvillimit të personelit janë të përshkruara në Manualin e Cilësisë. Procedura synon të sigurojë që kriteret dhe procedura për përzgjedhjen e stafit të jenë të drejta dhe transparente dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin e Punës dhe Ligjin për Arsimin e Lartë. Parimet që mbështesin procesin e rekrutimit janë ato të drejtësisë, besueshmërisë, mundësive të barabarta të punësimit dhe meritës. Vendimet për rekrutimin merren në kontekstin e një plani të përgjithshëm të personelit që merr parasysh nevojat afatgjata akademike dhe operacionale. Menaxheri i Burimeve Njerëzore është përgjegjës për zhvillimin, menaxhimin, vlerësimin dhe zbatimin e procedurave të përshtatshme të përzgjedhjes, emërimit dhe rekrutimit.